VENDIM
Nr. 755, datë 5.9.2013

PËR LEJIMIN E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR, SI AUTORITET KONTRAKTOR, TË PUBLIKOJË NJOFTIMIN E KONTRATËS SË NËNSHKRUAR PËR DISA OBJEKTE TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, si autoritet kontraktor, të publikojë njoftimin e kontratës së nënshkruar për disa procedura të prokurimit publik, si më poshtë:

- Ndërtimi i rrugëve paralele superstrada Tiranë – Vorë, krahu i majtë, vazhdimi (shtesë kontrate);
- Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti F. F-Unaza Tiranë (shtesë punimesh);
- Ndërtim, Rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan (shtesë punimesh)),
- Sistemim-asfaltim, rruga Kukës – Krumë, loti 2 (shtesë punimesh);
- Ndërtim i Rrugës së Arbërit (segmenti Ura e Brarit - Hyrje tuneli Qafë-Murrizë), loti 1 (shtesë punimesh));
- Sistemim-asfaltim, rruga Qafë-Thanë - Lin - Pogradec, loti 2 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, rikonstruksioni dhe zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, segmenti F. F-Unaza Tiranë (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan (shtesë punimesh));
- Supervizion punimesh, sistemim-asfaltim rruga Kukës – Krumë, loti 2 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, ndërtim i Rrugës së Arbërit (segmenti Ura e Brarit - Hyrje tuneli Qafë-Murrizë), loti 1 (shtesë punimesh);
- Supervizion punimesh, sistemim-asfaltim rruga Qafë-Thanë - Lin - Pogradec, loti 2 (shtesë punimesh).

2. Ngarkohen Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha